

Deklaratë për Shtyp



BANKA E SHQIPËRISË

Zyra e Shtypit
15 korrik 2008

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2008

1. NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË

1.1. Operacionet e tregut të hapur

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë).

DATA	Tërheqje likuiditeti			Injektivim likuiditeti
	REPO njëjavore	REPO njëmujore	REPO tremujore	R/REPO njëjavore
03.01.2008				0.00
10.01.2008	8,000.00			1,000.00
17.01.2008	8,090.00		660.00	
24.01.2008	7,000.00	1,350.00	250.00	
31.01.2008	5,000.00	1,100.00	360.00	
07.02.2008	2,950.00	260.00	10.00	
14.02.2008	1,000.00		0.00	
21.02.2008	360.00		60.00	
28.02.2008	2,000.00		1,000.00	
06.03.2008	2,000.00		800.00	
13.03.2008				0.00
20.03.2008				1,000.00
27.03.2008				2,000.00

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të parë të vitit 2008 përfshijnë operacione të tregut të hapur, kryesisht për tërheqjen e likuiditetit në përgjigje të tepicës së tij në sistemin bankar. Ndryshimi i situatës së likuiditetit në fund të tremujorit, kërkoi ndryshimin e kahut të operacioneve të Bankës së Shqipërisë në drejtim të injektivimit të likuiditetit.

Për të tërhequr likuiditetin gjatë dy muajve të parë të tremujorit Banka e Shqipërisë ka përdorur *marrëveshjen e riblerjes me maturim njëjavor*, mesatarisht 4.04 miliardë lekë në javë;

marrëveshjen e riblerjes me maturim njëmujor në tre raste, mesatarisht 0.9 miliardë lekë dhe *marrëveshjen e riblerjes me maturim tremujor* në tetë raste, mesatarisht 0.4 miliardë lekë. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë tërhoqi në mënyrë të

përherëshme 2 miliardë lekë, duke ulur portofolin e saj të bonove të thesarit të qeverisë.

Për injektimin e likuiditetit gjatë muajit të fundit të tremujorit Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e *marrëveshjes së anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor*, mesatarisht 1 miliardë lekë në javë.


1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2008, për investimin e likuiditeteve të lira, bankat përdorën depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 2.6 miliardë lekë, në krahasim me 1.34 miliardë lekë në tremujorin e kaluar.

Në kushtet e plotësimit të nevojave në tregun ndërbankar, instrumenti i kredisë njëditore gjeti përdorim minimal gjatë këtij tremujori, rreth 0.04 miliardë lekë në 6 raste përdorimi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërrhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, gjatë tremujorit të parë të vitit 2008.

Grafik 1: Ndërrhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë tremujorit të parë të vitit 2008.



2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

a. Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në tremujorin e parë të vitit aktual, Banka e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor. Rrjedhimisht nuk ka pasur veprime me bankat e nivelit të dytë.

b. Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe janë kryer veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Shitjet e valutës përcaktohen nga detyrimi i Qeverisë Shqiptare për shlyerjen e kësteve të borxhit të jashtëm. Tremujorin e kaluar janë kryer shitje të valutës edhe për efekt të shpenzimeve buxhetore në monedhë të huaj. Shitjet e kryera gjatë tremujorit të parë llogariten në 5,844.05 milionë lekë.

Vëllimi i blerjeve me Ministrinë e Financave gjatë kësaj periudhe që 2,027.05 milionë lekë. Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 92.20 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim, IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, IBRD).

Institucioni financiar	Blerje të valutës	Shitje të valutës
MINISTRIA E FINANCEVE	2,027.05	5,844.05
TË TJERA (IDA, IBRD)	92.20	-